



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:074294

Datë: 17.05.2019

Numri i dokumentit: 00314601

PKR. nr. 10/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti për Krime të Rënda në trupin gjykues të përbërë nga Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, Myfera Hoxha dhe Mentor Bajraktari, anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarit H. P. nga fshati ... i Ulët, Komuna Rahovec, për shkak të veprës penale falsifikim i parasë nga neni 302 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 83/2018 të datës 15.02.2019 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë **15.05.2019**, në prezencën e prokurorit Xhavit Osmani, të akuzuarit H. P. dhe mbrojtëses së tij B. K. avokate në Gjakovë, me datë 16.05.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **17.05.2019** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **H.P.I**, i biri i B. dhe S., e gjinisë A data e lindjes... në Rahovec, tani me banim në fshatin... i Ulët, Komuna Rahovec, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 09.09.2018, duke qenë në dijeni se paraja është e falsifikuar në rr. "G.S." në Gjakovë, pikërisht në Qendrën Tregtare në "E...", ka vënë në qarkullim një kartëmonedhë prej 100,00 € (njëqind euro) me numër . . . , në atë mënyrë që ditën kritike rreth orës 14:40/h, i pandehuri H.P. deri sa ishte në oborrin e . . . -së, duke shitur pemë dhe perime, kishte shkuar një veturë me tre persona të cilët kishin blerë gjësende në vlerë prej 20,00 € dhe me rastin e pagesës kanë paguar me një monedhë në vlerë prej 100,00 €, i njëjti më pas me paranë e falsifikuar në vlerë prej 1x100,00 €, ka shkuar në Qendrën Tregtare ". . ." ka blerë një pije freskuese me kartëmonedhën e falsifikuar, ku pas një kontrole nga arkëtarja, pasi vëren që kartëmonedha është e falsifikuar, e lajmëron sigurimin të cilët më pas lajmërojnë policinë të cilët paranë e falsifikuar e konfiskojnë dhe pas ekzaminimit të kartëmonedhës nga Agjensioni i Forenzikës me numër . . . të datës 23.10.2018, e njëjta rezulton falsifikim i plotë.

- me çka ka kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 2 të KPRK-së

Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 41, 49, 50, 51, 52 par. 2, 73, 74, 75, 76 par. 1 nën par.1.5, 302 par. 2 dhe nenit 365 të KPP-së, e:

G J Y K O N

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 50,00 €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50,00 € në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet bankënota e falsifikuar në apoen prej 100,00 € me numër serik . . . , si objekt i kryerjes së kësaj vepre penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktakuzën PP/I. nr. 83/2018 të datës 15.02.2019 ka akuzuar H.P. nga fshati ..., Komuna Rahovec, për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 2 të KPRK-së.

Prokurori Xhavit Osmani në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e çmon dhe vlerëson pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili pranim është bërë pas konsultimeve me mbrojtësen e tij, por që ky pranim i fajësisë ka mbështetje edhe në shkresat e lëndës, si në dëshminë e dëshmitarit, bankënotën e gjetur, ekspertizën nga Agjencioni i Kosovës për Forenzikë, ashtu që janë të mendimit se aktakuza është e bazuar. Ka shtuar se gjykatës ia vë në dijeni se i akuzuari është për herë të parë si kryes i veprës penale, ka gjendje të varfër ekonomike, punon si shitës ambulatorë me pemë dhe perime, ashtu që e çmon pendimin e tij në të gjitha fazat.

Mbrojtësja e të akuzuarit H. P.i, avokatja B. K.në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi i saj e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, andaj i propozon gjykatës që me rastin e matjes së lartësisë së dënimit, të vlerësoi si rrethanë posaçërisht lehtësuese, pranimin e fajësisë, gjendjen e varfër ekonomike, moshën e re, faktin se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar dhe ndaj të njëjtit nuk zhvillohet asnjë procedurë penale, pendimi i sigurtë dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprim të tillë. Ka theksuar se konsiderojnë se edhe me një dënim më të butë do të arrihet risocializimi dhe preventiva gjenerale dhe e posaçme e tij, si dhe shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

I akuzuari H.P. edhe pse në seancën e shqyrtimit fillestar nuk e ka pranuar fajësinë, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e pranon në tërësi fajësinë, të cilin pranim e ka bërë pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij.

Pasi që gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale që i vihen në barrë, është bindur se pranimin e fajësisë e ka bërë në bazë vullnetare, pas konsultimeve paraprake me mbrojtësen e tij, ka konstatuar se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat e bashkëngjitur aktakuzës si dëshmia e dëshmitarit V.R. e dhënë në prokurori me datë 29.01.2019, fotoja e bankënotës, dëftesa mbi konfiskimin e pronës-kartëmonedhës në apoen prej 100,00 €, raporti i oficerit policor i datës 09.09.2018,

raporti i ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë e datës 23.10.2018, me të cilën është e konstatuar se kartëmonedha është falsifikim i plotë, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 326 par. 4 të KPP-së dhe shqyrtimin e ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale, në mënyrën, kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, nuk ka gjetur rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marr parasysh pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, jo dënueshmërinë tij të mëparshme, gjendjen e varfër ekonomike, e të cilat rrethana kanë ndikuar që gjykata ti aplikoi dispozitat e zbutjes së dënimit dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim nën minimumin e përcaktuar ligjor dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e bankënotës së falsifikuar në apoen prej 100,00 € me numër serik . . . , si objekt i kryerjes së kësaj vepre penale, është marrë bazuar në nenin 302 par. 6 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2, nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
PKR. nr. 10/19 datë 17.05.2019

Sekretarja Juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Nikollë Komani

Udhëzim juridikë: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankesë në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afatin prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.